



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRÉ)

Rregulla për certifikimin e operatorëve të sistemit të transmetimit

Prill, 2017



Përmbajtja

NENI 1 QËLLIMI	3
NENI 2 MODELI I SHTHURJES	4
NENI 3 OBJEKTIVI DHE SHTRIRJA E CERTIFIKIMIT	4
NENI 4 APLIKUESHMËRIA.....	4
NENI 5 DEFINICIONET DHE INTERPRETIMI.....	5
NENI 6 OBLIGIMET PËR CERTIFIKIM	6
NENI 7 APLIKIMI PËR CERTIFIKIM	6
NENI 8 KËRKESA PËR CERTIFIKIM	6
NENI 9 DOKUMENTET DHE INFORMATAT	6
NENI 10 PYETËSORI	7
NENI 11 VERIFIKIMI.....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
NENI 12 KRITERET E CERTIFIKIMIT.....	8
NENI 13 SHQYRTIMI I APLIKACIONIT	10
NENI 14 KONSULTIMET PARA NJOFTIMIT ME SKE	10
NENI 15 VENDIMI PRELIMINAR PËR CERTIFIKIM	11
NENI 16 DORËZIMI I DOKUMENTEVE DHE INFORMATIVE TE SKE	11
NENI 17 SHQYRTIMI I VENDIMIT PRELIMINAR NGA SKE.....	12
NENI 18 VENDIMI FINAL I ZRRE-SË	12
NENI 19 CERTIFIKIMI NË RAPORT ME VENDET E TRETA.....	12
NENI 20 RIHAPJA E PROCEDURËS SË CERTIFIKIMIT.....	13
NENI 21 RAPORTIMI PËR CERTIFIKIMIN	13
NENI 22 HETIMET	14
NENI 23 KONFIDENCIALITETI.....	14
NENI 24 GJUHA ZYRTARE	14
NENI 25 INTERPRETIMI	15
NENI 26 PLOTËSIM-NDRYSHIMET E RREGULLËS	15
NENI 27 HYRJA NË FUQI	15



Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (“ZRRE”), në pajtim me nenin 11.5 dhe 12 të Ligjit për Energjinë Elektrike nr. 05/L-085, nenin 39 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë nr. 05/L-084 dhe nenin 16 të Ligjit për Gazin Natyror nr. 05/L-082, në sesionin e mbajtur më _____, ka miratuar këtë:

RREGULLA PËR CERTIFIKIMIN E OST-ve

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj rregulle është që të vendos një procedurë transparente dhe të besueshme të certifikimit, që siguron që operatori i sistemit të transmetimit (“OST”) përputhet plotësisht me kriteret e shturjes sikurse janë përcaktuar me kapitujt IV dhe V të Direktivës 2009/72/EC¹ dhe kapitujt III dhe IV të Direktivës 2009/73/EC, dhe i transpozuar në legjislacionin e Kosovës nëpërmjet nenit 11 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe nenin 15 të Ligjit për Gazin Natyror. Certifikimi është proces sipas të cilit ZRRE-ja konfirmon që ka ndarje të mjaftueshme të kontrollit mbi OST-në në njërën anë, dhe mbi prodhimin dhe/apo furnizimin në anën tjetër dhe që ndërmarrja e energjisë është në pajtueshmëri me dispozitat e shturjes që janë relevante për te.
2. Certifikimi i OST-ve kërkohet me qëllim të sigurimit që OST të realizojë funksionet e saj në mënyrë të pavarur nga çfarëdo biznesi tjetër në sektorin e energjisë dhe rrjedhimisht të sigurohet që OST-ja e tillë të ofrojë qasje të lirë dhe jodiskriminuese në rrjetin e transmetimit. Duke e lëshuar këtë rregull, ZRRE-ja do të përmbush kërkesat e detyrueshme të Ligjit për Energjinë Elektrike, Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligjit për Gazin Natyror në pajtim me dispozitat e shturjes që referohen në paragrafin 1 më lart.
3. Kjo rregull është lëshuar në pajtim me nenin 39 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Neni 39 e obligon ZRRE-në që të hartojë dhe miratojë rregullat, kriteret dhe procedurat për certifikimin e ndërmarrjes së energjisë që përmbush kriteret e shturjes si një Operator i Sistemit të Transmetimit.

¹ - Direktiva 2009/72/EC e Parlamentit European dhe Këshillit e dt. 13 Korrik 2009 lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/54 / EC , OJ L 211/55 of 14.8.2009;

- Direktiva 2009/73/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 korrik 2009 në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/55 / EC, L 211/94 OJ të 14.8.2009



Neni 2 Modeli i shthurjes

1. Ligji për Energjinë Elektrike dhe Ligji për Gazin Natyror parashohin modelin e shthurjes së pronësisë për OST-në, që kërkon emërimin e pronarit të sistemit të transmetimit si OST dhe pavarësinë e tij nga prodhimi dhe furnizimi.

Neni 3 Objektivi dhe shtrirja e certifikimit

1. Objektivi i kësaj rregulle është që të sigurojë që secila procedurë e certifikimit e kryer nga ZRRE, do të realizohet me konsistencë dhe në mënyrë transparente dhe në linjë me legjislacionin e aplikueshëm. Ky dokument synon të ngrit eficiencën e procesit të certifikimit dhe në të njëjtën kohë të siguroj një nivel më të lartë të parashikueshmërisë sa i përket procesit të rishikimit për të gjitha palët e interesit.
2. Kjo rregull përcakton procedurat për aplikim për certifikimin e OST-së, kriteret për aplikim dhe kushtet e afatet kohore për dorëzimin e dokumenteve të kërkuara për certifikim. Ajo më tej përshkruan mënyrën se si procedura e certifikimit duhet të kryhet nga ZRRE dhe si e vlerëson Sekretariati i Komunitetit të Energjisë vendimin preliminar të lëshuar nga ZRRE për certifikim. Kjo rregull po ashtu përmban procedurat e raportimit dhe monitorimit për pajtueshmërinë e certifikimit.

Neni 4 Aplikueshmëria

1. Asnjë ndërmarrje e energjisë nuk mund të përcaktohet dhe miratohet si një operator i sistemit të transmetimit në kuptimin e nenit 10 të direktivave 72/2009/EC dhe 73/2009/EC derisa nuk është certifikuar nga Rregullatori nacional që i ka përmbushur kërkesat për shthurje të kërkuara sipas ligjit.
2. Ndërmarrja e energjisë e cila operon sistemin e transmetimit të energjisë elektrike në Kosovë sipas një licence të dhënë nga ZRRE-ja para hyrjes në fuqi të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë 05/L-084, do të vazhdojë të operojë sipas kushteve të kësaj licence deri sa të lëshohet një licencë e **përhershme** sipas paragrafit 4 më poshtë.
3. Cilado ndërmarrje tjetër e energjisë ndryshe nga ajo që përmendet në paragrafin 2 më lart, e cila dëshiron që të operojë një sistem transmetimi duhet të aplikojë te ZRRE-ja për licencë sipas nenit 39 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullës për Licencimin e Ndërmarrjeve të Energjisë të nxjerrë nga ZRRE. Çfarëdo licence e dhënë nga ZRRE që pason një aplikacion të tillë duhet të konsiderohet e përkohshme derisa të certifikohet ndërmarrja e energjisë.
4. Brenda 1 (një) muaji pas lëshimit të vendimit final për certifikim sipas nenit 18 më poshtë, ZRRE duhet të lëshojë një licencë të **përhershme** OST-së, e cila duhet të jetë efektive që nga data e certifikimit.

Neni 5 Definicionet dhe interpretimi

1. Termat e përdorur në këtë rregull kanë kuptimet si më poshtë:
 - 1.1 “Aplikuesi” i referohet një ndërmarrje të energjisë që aplikon te ZRRE-ja për certifikim;
 - 1.2 “Bordi” i referohet Bordit të ZRRE-së;
 - 1.3 “Informacion konfidencial” nënkupton të dhëna, dokumente apo informata të tjera, qoftë komerciale apo teknike, të ndërlidhura me projektimin, rehabilitimin, sigurimin, operimin, mirëmbajtjen dhe financimin e operacioneve apo aktiviteteve të ndërlidhura me energjinë që ende nuk janë në sferën publike dhe që mund të rrezikojnë interesin komercial të aplikuesve dhe të licencuarve nëse zbulohen
 - 1.4 “Kontrolli” nënkupton të drejtat, kontratat ose mjetet e tjera të cilat, ndaras apo në kombinim ndërmjet tyre dhe, duke pasur parasysh ligjet apo faktet e përfshira, i japin mundësinë për të ushtruar influencë vendimtare mbi një ndërmarrje të energjisë, veçanërisht nga:
 - Pronësia apo e drejta për të shfrytëzuar të gjitha ose pjesë të caktuara të aseteve të një ndërmarrjeje të energjisë;
 - Të drejtat apo kontratat që u japin influencë vendimtare mbi përbërjen;
 - Votimet ose vendimet e organeve të një ndërmarrjeje të energjisë.
 - 1.5 “Operatori i sistemit të distribucionit” nënkupton një person fizik apo juridik përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjes dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e një sistemi të distribucionit në një zonë të caktuar dhe, aty ku është e aplikueshme, ndërlidhjet e tij me sistemet e tjera dhe për të siguruar mundësinë afatgjatë të sistemit për të arritur kërkesa të arsyeshme për shpërndarjen e energjisë elektrike.
 - 1.6 “Operatori i sistemit të transmetimit” është një person fizik apo juridik përgjegjës për operimin, sigurimin e mirëmbajtjes dhe, nëse është e nevojshme, zhvillimin e një sistemi të transmetimit. Në rastin e kësaj rregulle, është KOSTT-i ose ndonjë OST tjetër ndërlidhës (interkonektor) në sektorin e energjisë elektrike apo të gazit;
 - 1.7 “I licencuari” i referohet mbajtës-it/ve të licencës/ave;
 - 1.8 “Furnizuesi” është një ndërmarrje e energjisë e licencuar për të realizuar aktivitete të furnizimit.

Termet e përdorura në këtë rregull duhet të kenë kuptimin e specifikuar në Ligjin për Energjinë Elektrike nr. 05/L-085, Ligjin për Gazin Natyror nr. 05/L-082 dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë nr. 05/L-084.

KAPITULLI II APLIKIMI PËR CERTIFIKIM

Neni 6 Obligimet për certifikim

1. Një ndërmarrje e energjisë që aplikon për certifikim duhet të dokumentojë te ZRRE-ja që ajo i përmbush kërkesat për shturje sipas nenit 11 të Ligjit për Energjinë Elektrike, nenit 15 të Ligjit për Gazin Natyror dhe kriterëve të certifikimit të nenit 12 në këtë rregull.

Neni 7 Aplikimi për certifikim

1. Ndërmarrja e energjisë që përmendet në nenin 6 (këtu e tutje “Aplikuesi”) duhet të dorëzojë te ZRRE-ja një aplikacion për certifikim që përmban:
 - a) Kërkesë me shkrim për certifikim;
 - b) Dokumentet dhe informatat që kërkohen në mënyrë që të dokumentohen kriteret sikurse në nenin 12 të kësaj rregulle; dhe
 - c) Pyetësin e kompletuar për certifikimin e OST-së, në formën që ofrohet nga Komisioni Evropian, sikurse është përshkruar në nenin 10 më poshtë.
2. Aplikuesi do të ndjek procedurën për aplikim sikurse është vendosur në nenin 39 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe në këtë rregull.
3. Kur aplikuesi konsideron se aplikacioni i tij është i plotë për kah përmbajtja, ai duhet ta diskutojë me ZRRE-në dorëzimin e tij, para dorëzimit final. Kjo do t’i mundësojë ZRRE-së dhe aplikuesit për të diskutuar joformalisht dorëzimin e propozuar dhe veçanërisht qëllimin e informacionit që do të dorëzohet. Kjo do t’i mundësojë OST-së që të identifikojë çfarëdo informatash plotësuese që mund të kërkohen, ose të ofrojë ndonjë qartësim për informatat që tashmë janë përfshirë.

Neni 8 Kërkesa për certifikim

1. Aplikuesi për certifikim duhet të dorëzojë te ZRRE një kërkesë me shkrim që tregon arsyet për aplikim për certifikim. Një listë e gjitha dokumenteve që dorëzohen në përkatje të aplikacionit duhet t’i bashkëngjitet kërkesës.
2. Kërkesa për certifikim duhet të nënshkruhet nga drejtori menaxhues apo, në mungesë të tij, nga zëvendësuesi.

Neni 9 Dokumentet dhe informatat

1. Aplikuesi duhet të dorëzojë te ZRRE të gjitha dokumentet dhe informatat e kërkuara për certifikim në pajtim me kriteret e vendosura në nenin 12 të kësaj rregulle. Të gjitha dokumentet e përfshira duhet të jenë në gjuhën angleze dhe shqipe, në formë të shkruar

dhe elektronike. Dokumentet duhet të dorëzohen në kopje origjinale, ose në kopje të noterizuara.

2. Gjatë procedurës së certifikimit, ZRRE-ja ka të drejtë të marr nga aplikuesi çfarëdo informata të tjera që janë të nevojshme për të siguruar përmbushjen e kritereve të shturjes. Kjo e drejtë i jepet edhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë ("SKE"), që gjatë shqyrtimit të vendimit preliminar për certifikim të nxjerrë nga ZRRE, të ketë qasje të plotë në dokumentet dhe informatat që janë të ndërlidhura me çështjen e certifikimit. Për këtë qëllim, SKE ka të drejtën të kontaktojë OST-në që aplikon për certifikim, sikurse dhe palët e tjera të interesit në sektorin e energjisë (prodhuesit dhe furnizuesit).
3. Në përkrahje të aplikacionit të tij, aplikuesi duhet të ofrojë qartësime dhe shkresa shpjeguese kurdo që është e nevojshme për të qartësuar çfarëdo dokumenti të veçantë, mungesë të informacionit, ose për të theksuar relevancën e fakteve dhe referencat ndaj çfarëdo dokumenti ligjor.

Neni 10 Pyetëtori

1. Aplikuesi do të dorëzojë te ZRRE-ja një pyetësor që përmendet në paragrafin 3 më poshtë, i kompletuar me informatat specifike në lidhje me kërkesat e shturjes, së bashku me dokumentet përkrahëse.
2. Pyetëtori synon të përshkruaj informatat që janë të nevojshme për ZRRE-në për vendimin e saj preliminar në certifikim dhe për SKE-në që të kryej vlerësimin e saj për këtë vendim preliminar.
3. Pyetëtori që është Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit mbi certifikimin e operatorëve të sistemit të transmetimit të rrjeteve për energjinë elektrike dhe gazin natyror në Bashkimin Evropian, i nxjerrë nga Komisioni Evropian më 29.9.2011, nr. SEC (2011) 1095, ose çfarëdo dokumenti që e zëvendëson atë.
4. Çfarëdo informata apo dokumentesh që nuk kërkohen në mënyrë eksplicite nga pyetëtori duhet të dorëzohen te aplikuesi nëse ZRRE apo aplikuesi konsideron se këto informata ose dokumente janë relevante për vlerësimin e kërkesës së certifikimit.

Neni 11 Verifikimi

1. Aplikuesi është përgjegjës që të sigurohet që i ka ofruar të gjitha informatat dhe dokumentet e nevojshme në përkrahje të aplikacionit të tij. Sidoqoftë, kur aplikuesi nuk mund të siguroj ndonjë dokument ose informatë atëherë ai duhet që menjëherë të ngrit këtë çështje te ZRRE-ja apo cilido autoritet publik në Kosovë që mund ta asistojë atë.
2. Është përgjegjësia e aplikuesit që të sigurohet që dokumentet dhe informatat e ofruara në përkrahje të aplikacionit të tij është verifikuar para dorëzimit dhe e vlerësuar si e

saktë, e vërtetë dhe e plotë. Aty ku konsiderohet e nevojshme, aplikuesi duhet të ofrojë kopje të noterizuara të dokumenteve origjinale.

3. Procedura e verifikimit e përshkruar në paragrafin 2 më lart duhet të përfshijë obligimin e drejtorit menaxhues që të sigurohet që secili dokument ose deklaratë brenda aplikacionit të jetë e saktë, e vërtetë dhe e plotë. Ky verifikim duhet të përdoret si garanci e saktësisë së informatave të ofruara te ZRRE dhe t'i mundësojë ZRRE-së që të ketë besim në informatat, pa pasur nevojë që të duplikojë procesin e verifikimit.

KAPITULLI III KRITERET E CERTIFIKIMIT

Neni 12 Kriteret e certifikimit

1. Kriteret që një aplikues duhet t'i përmbush në mënyrë që të certifikohet nga ZRRE-ja janë ato që përshkruhen në nenin 11 të Ligjit për Energjinë Elektrike, në Direktivën 209/72-EC dhe Rregulloren EC Nr. 741/2009 për energjinë elektike, dhe ato të përshkruara në Nenin 16 të Ligjit për Gazin Natyror, në Direktivën 2009/73/EC dhe Rregulloren (EC) Nr. 715/2009. Aplikuesi dhe ZRRE-ja duhet të vlerësojnë pajtueshmërinë e aplikuesit duke iu referuar këtyre kriterëve.
2. Dokumentet e ofruara duhet të përfshijnë material që demonstroi që aplikuesi ka vepruar në pajtim me të gjitha pikat si në praktikë ashtu dhe në legjislacion, dhe që dokumenton **pronësinë e sistemit të transmetimit nga OST-ja**.
3. Gjatë aplikimit për certifikim, aplikuesi ka nevojë të paraqes dokumente që demonstrojnë që janë përmbushur kriteret në nenin 11.1 të Ligjit për Energjinë Elektrike ose gazit natyror, dhe se Aplikuesi e posedon sistemin e transmisionit.
4. Duke vërtetuar pronësinë e tij mbi sistemin e transmisionit nën paragrafin 2 si më lartë, aplikuesi duhet të ketë parasysh veçanërisht të siguroj:
 - 4.1 Dokumentet ligjore që demonstrojnë përvetësimin ose transferimin te aplikuesi të aseteve që përbëjnë sistemin e transmisionit;
 - 4.2 Çfarëdo dispozitash relevante të legjislacionit primar ose sekondar, duke përfshirë dispozitat në çfarëdo rregulle, vendim apo licence të ZRRE-së;
 - 4.3 Dokumentet qeverisëse të aplikuesit, kur këto i referohen pronësisë mbi sistemin e transmetimit;
 - 4.4 Çfarëdo dokumentesh të tjera relevante që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit mbi sistemin e transmetimit - Kontrolli dhe pronësia mbi OST-në



5. Gjatë aplikimit për certifikim, aplikuesi duhet të paraqes dokumentet që dëshmojnë se i ka përmbushur kriteret:
 - 5.1 Sa i përket energjisë elektrike, kriteret e përfshira nga Nenet 11.2 deri 11.4, Nenet 13 dhe Nenet 14 të Ligjit për Energjinë Elektike;
 - 5.2 Sa i përket gazit natyror, kriteret e përfshira në Nenet 15.2 deri në 15.6, Nenet 19,20 dhe 21 të Ligjit për Gazin Natyror.
6. Gjatë demonstrimit se si aksionari apo aksionarët e aplikuesit ushtrojnë të drejtën e tyre sipas paragrafit 5 më lart, aplikuesi duhet të ketë parasysh posaçërisht:
 - 6.1 Dokumentet ligjore që dëshmojnë identitetin e aksionarit ose aksionarëve, duke përfshirë përqindjen e secilit aksionar, si dhe kopjet e secilës certifikatë të aksioneve;
 - 6.2 Çfarëdo dispozitash relevante të legjislacionit primar apo sekondar që përshkruajnë të drejtat e votimit të aksionarëve apo çfarëdo çështje tjetër të ndërlidhur me sistemin e transmetimit;
 - 6.3 Çfarëdo dispozitash relevante të legjislacionit primar apo sekondar që përshkruajnë autoritetin e aksionarit për t'i emëruar anëtarët e bordit mbikëqyrës, bordit administrativ apo çfarëdo organi tjetër ligjor që përfaqëson ligjërisht aplikuesin;
 - 6.4 Çfarëdo dispozitash relevante të legjislacionit primar apo sekondar që përshkruajnë çfarëdo limitimesh mbi interesat pronësore të aksionarit në prodhim dhe furnizim;
 - 6.5 Kur aplikuesi është në pronësi publike, ai ka nevojë të dëshmojë se kompetencat e personit juridik që ushtron kontrollin mbi OST-në ose sistemin e transmetimit janë të veçanta dhe të ndara nga kompetencat e personit që ushtron kontroll mbi cilindo ndërmarrje që bën prodhimin apo furnizimin;
 - 6.6 Çfarëdo procedure relevante interne, kode, deklarata, dokumente trajnuese, udhëzime të stafit, etj. që dëshmon masat e marra nga aplikuesi për të siguruar që (a) nuk ka një konflikt interesi që influencon vendim-marrjen e aplikuesit në operimin e sistemit të transmetimit dhe (b) nuk ka thyerje të rregullave të konfidencialitetit të të dhënave të përdoruesit.

Detyrat e OST-së

7. Gjatë aplikimit për certifikim, aplikuesi duhet të paraqes dokumentet që dëshmojnë se aplikuesi ka kompetencat ligjore për të kryer detyrat e renditura në nenin 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike ose në Nenin 18 të Ligjit për Gazin Natyror.

KAPITULLI IV SHQYTIMI I APLIKACIONIT

Neni 13 Shqyrtimi i aplikacionit

1. Kur ZRRE-ja e pranon aplikacionin, siç referohet në nenin 7 më lart, ajo do të shqyrtojë dokumentet e dorëzuara. Informacioni i dorëzuar nga aplikanti do të vlerësohet rast pas rasti për çdo OST që aplikon për certifikim.
2. Sipas nenit 39.5 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE-ja duhet të lëshojë vendimin e saj preliminar brenda një periudhe katër (4) muajshe nga dita e pranimit të një aplikacioni të kompletuar për certifikim në kuptimin e nenit 7.1 më lart.
3. Brenda periudhës katër (4) mujore të shqyrtimit, ZRRE-ja mund të kërkojë nga aplikuesi informata të mëtutjeshme plotësuese dhe aplikuesi duhet të bëjë çdo përpjekje për t'iu përgjigjur shpejt dhe në tërësi çfarëdo kërkesë tjetër për informacion.
4. Kur, pas dorëzimit të aplikacionit të ZRRE-ja, aplikuesi informohet për çfarëdo ndryshimi të dokumenteve, të dhënave apo informatave të paraqitura në aplikacionin e tij, ai duhet ta njoftojë menjëherë ZRRE-në sapo të kuptojë një ndryshim të tillë dhe duhet të prezantojë dokumentet e rishikuara apo sqaruese dhe informatat e nevojshme për të dokumentuar një modifikim të tillë.

Neni 14 Konsultimet para njoftimit me SKE

1. Së paku 6 (gjashtë) javë para dorëzimit formal të vendimit të saj preliminar të SKE, ZRRE-ja do ta informon SKE-në për njoftimin dhe do të kërkojë një takim konsultues, dhe do ta njoftojë KOSTT-in për veprimin e ndërmarrë dhe për datën e planifikuar të takimit.
2. Kur kërkohet nga SKE, ZRRE-ja mund të ofrojë, para çfarëdo takimi konsultues:
 - 2.1 Një përshkrim të përputhshmërisë/mungesës së përputhshmërisë së OST-së me kërkesat e nenit 9 të Direktivave të Energjisë Elektrike apo të Gazit, siç kërkohet;
 - 2.2 Gjuhën e njoftimit;
 - 2.3 Numrin e përafërt të faqeve të vendimit preliminar dhe numrin e përafërt të faqeve të pyetësorit të kompletuar dhe arsyetimet;
 - 2.4 Numrin e faqeve të dokumenteve përkrahëse.
3. Duke ofruar informatat e paraqitura në paragrafët 2.1 dhe 2.4 më lart, ZRRE-ja duhet të tregojë, në mënyrë të qartë seksionet që janë identifikuar si relevante për lëshimin e vendimit preliminar.

KAPITULLI V VENDIMET PËR CERTIFIKIM

Neni 15 Vendimi preliminar për certifikim

1. Në pajtim me nenin 39.5 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE-ja duhet të përgatis vendimin preliminar mbi certifikimin e OST-së brenda katër (4) muajsh nga dita e pranimit të aplikacionit për certifikim me dokumentet përkrahëse.
2. Nëse vendimi preliminar mbi certifikimin nuk lëshohet brenda afatit të lartpërmendur, do të konsiderohet që ZRRE-ja e ka dhënë këtë certifikim.
3. Menjëherë pas marrjes së vendimit preliminar për certifikim, ZRRE-ja duhet të njoftojë aplikantin duke ia paraqitur komplet arsyetimin e saj.
4. Pavarësisht nëse vendimi preliminar është miratuar, ose nënkuptohet si në paragrafin 2 më lart, ZRRE duhet menjëherë të njoftoj SKE-në dhe të dërgoj të gjitha dokumentet përkrahëse.

Neni 16 Dorëzimi i dokumenteve dhe informative te SKE

1. Vendimi preliminar, edhe nëse është negativ, duhet të dorëzohet te SKE.
2. Kur e dorëzon vendimin preliminar te SKE, ZRRE-ja duhet të bashkëngjis si në vijim:
 - a) Pyetësin e plotësuar së bashku me dokumentet përkrahëse.
 - b) Dokumentet/informatat shtesë që nuk janë kërkuar në mënyrë eksplicite në pyetësor, por të cilat aplikuesi i ka dorëzuar te ZRRE dhe mbi të cilat ZRRE-ja është bazuar gjatë vlerësimit të kërkesës së certifikimit. Në këtë rast, ZRRE-ja duhet të rendis të gjitha informatat/dokumentet shtesë, ofrojë një përshkrim të shkurtër të përmbajtjes dhe të shpjegojë se pse i konsideron informatat/dokumentet shtesë të vlefshme për shqyrtimin e kërkesës për certifikim.
3. Kur një ndërmarrjeje të energjisë në Kosovës (qoftë aplikues për certifikim ose jo) i kërkohet nga SKE të ofrojë informata ose dokumente, ndërmarrja e tillë do të jetë në pajtim me kërkesën sa më herët që është e mundur, sikurse kërkesën e tillë ta ketë bërë ZRRE-ja në kuadër të kompetencave të saj në nenin 12 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Ndërmarrja do të dorëzojë ZRRE-së një kopje të të gjitha informatave apo dokumenteve të ofruara SKE.
4. Kur ndërmarrja e energjisë, sipas paragrafit 3 më lart nuk është në gjendje të përmbush kërkesën për çfarëdo arsyeje, ajo duhet që menjëherë të njoftojë SKE dhe ZRRE dhe t'i shpjegojë arsyet për pamundësinë e realizimit të saj.

Neni 17 Shqyrtimi i vendimit preliminar nga SKE

1. Afati për shqyrtimin e vendimit të përkohshëm të ZRRE-së nga SKE është 4 (katër) muaj nga data e njoftimit nga ana e ZRRE-së.
2. Në mungesë të një opinioni nga SKE brenda periudhës prej 4 (katër) muajsh pas ditës së pranimit të dorëzimit të ZRRE-së, do të konsiderohet se nuk ka vërejtje ndaj vendimit preliminar të marrë nga ZRRE.
3. Në rast të opinionit negativ nga SKE, ZRRE-ja duhet të merr parasysh komentet e ofruara gjatë përgatitjes së vendimit të saj final.

Neni 18 Vendimi final i ZRRE-së

1. Brenda dy (2) muajsh pas pranimit të opinionit nga SKE, ZRRE-ja do të lëshojë një vendim final për sa i përket certifikimit të OST-së. ZRRE-ja do të bazohet në mënyrë të konsiderueshme te opinionin e SKE-së dhe do të publikojë në webfaqen e saj vendimin final për certifikimin së bashku me opinionin e SKE.
2. Kur vendimi final i ZRRE-së dallon nga opinionin e SKE, ZRRE-ja do të publikojë, në webfaqen e saj zyrtare, vendimin e saj final mbi certifikimin, së bashku me arsyetimin për këtë vendim dhe opinionin e SKE.

KAPITULLI VI

CERTIFIKIMI NË RAPORT ME VENDET E TRETA DHE RIHAPJA E PROCESIT TË CERTIFIKIMIT

Neni 19 Certifikimi në raport me vendet e treta

1. Kur një aplikues për certifikim, është nën kontrollin nga një apo më shumë personave nga një vend ose vende jashtë Kosovës, ZRRE-ja duhet ta njoftojë SKE.
2. ZRRE-ja duhet ta njoftojë SKE pa vonesa kur kupton se ekzistojnë rrethana që mund të rezultojnë me mundësinë që një apo më shumë persona nga vendet e treta të marrin kontrollin mbi një sistem transmetimi ose një OST.
3. Procedura e certifikimit në raport me vendet e treta do të ndjek procedurën dhe afatet e njëjta kohore të vendosura nga kapitulli II deri te kapitulli V në këtë rregull dhe kërkesat e parashtruara në nenin 40 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 20 Rihapja e procedurës së certifikimit

1. Në pajtim me kompetencat e saj për monitorimin e përputhshmërisë së OST-ve me kërkesën për pavarësinë dhe ndarjen e aktiviteteve, ZRRE do të rihap procedurën e certifikimit për të siguruar pajtueshmërinë në rastet si në vijim:
 - a) Bazuar në njoftimin nga OST që rrethanat kanë ndryshuar, ose mund të ndryshojnë, dhe që ndryshimi i tillë mund të ndikojë në përputhjen me kriteret e shthurjes.
 - b) Me iniciativë vetanake, kur njoftohet me ndryshimet e caktuara në të drejtat ose ndikimin mbi OST që mund të rezultojë me shkeljen e kërkesave relevante për pavarësi dhe ndarjen e aktivitetit të OST-së nga aktivitetet e prodhimit dhe furnizimit ose kur ka arsye të besueshme për të besuar që ka ndodhur kjo shkelje; ose
 - c) Bazuar në kërkesën e arsyeshme nga SKE.
2. Kur, pas një vendimi final nga ZRRE, aplikuesi kupton se informata, bazuar në të cilën ZRRE është mbështetur në marrjen e vendimit të saj final, ka ndryshuar, aplikuesi duhet ta njoftojë menjëherë ZRRE-në. Nëse ZRRE-ja beson se kanë ndryshuar informatat, ajo mund të hap një procedurë të re certifikimi për aplikuesin.
3. Bazuar në këtë nen, procedura e certifikimit e rihapur nga ZRRE do të zbatohet në të njëjtën mënyrë sikurse parashihet në këtë rregull për çfarëdo kërkesë të re për certifikim.
4. Rihapja e procedurës së certifikimit do të rezultojë me vendimmarrje të re mbi certifikimin e OST, që mund të rezultojë në nxjerrjen e licencës së re për OST-në.

KAPITULLI VII

PROCEDURA E RAPORTIMIT DHE MONITORIMIT

Neni 21 Raportimi për certifikimin

1. Zbatimi i duhur i kësaj rregulle do të mundësohet, monitorohet dhe mbikëqyret nga ZRRE.
2. OST i licencuar do të dorëzojë te ZRRE, jo më vonë se më 31 janar të secilit vit, një raport mbi pajtueshmërinë e certifikimit në vitin kalendarik të mëparshëm. Raporti do të ofrohet në një format të përshtatshëm për publikim në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.
3. Kur raporti përmban informata konfidenciale, i licencuari do të ofrojë një version të plotë të raportit për shqyrtim nga ZRRE dhe një version të ndarë për publikim:
 - a) Raporti do të nënshkruhet nga drejtori menaxhues i OST-së ose personi i autorizuar nga ai.



- b) Raporti do të shqyrtohet nga ZRRE dhe publikohet në webfaqen e saj zyrtare. Përveç raportit, ZRRE-ja do të publikojë vlerësimin e saj të raportit, që, në veçanti, do të identifikojë nëse ka shkelje të pajtueshmërisë me certifikatën dhe çfarëdo dënimi të propozuar dhe/apo masë ndëshkuese që ZRRE propozon për të aplikuar për këto shkelje.

Neni 22 Hetimet

1. ZRRE, me iniciativë vetanake, mund të kryejë hetime ndaj operimit të OST-së.
2. Nga OST-ja kërkohet t'i lehtësojë këto hetime dhe, në veçanti, të lejoj qasje në të gjithë dokumentacionin, në objektet e saj dhe te të punësuarit dhe kontraktorët e saj si, si kërkohet nga ZRRE-ja me qëllim të hetimit.
3. ZRRE-ja do t'i publikojë konkluzionet e hetimit të saj në webfaqen e saj zyrtare.
4. OST-së do t'i ofrohet mundësia për të shqyrtuar draft konkluzionet para publikimit dhe mund të ofrojë përgjigje dhe të kërkojë redaktimin e informatave konfidenciale. Çfarëdo përgjigje që ofrohet nga OST do të publikohet bashkë me konkluzionet e hetimit të ZRRE-së.

KAPITULLI VIII DISPOZITAT FINALE

Neni 23 Konfidencialiteti

1. Kur dokumentet ose informatat e dorëzuara nga aplikuesi te ZRRE-ja, përmbajnë informata konfidenciale, aplikuesi duhet që qartazi të specifikojë se cilat pjesë të dokumenteve ose informatave duhet të konsiderohen si konfidenciale.
2. Kur asnjëri dokument nuk vlerësohet si konfidencial, ZRRE-ja ose SKE do të vlerësojnë se informatat e dorëzuara nga aplikuesi mund të zbulohen për publikun.
3. Kur ndonjëri nga dokumentet e dorëzuara në procesin e certifikimit vlerësohet si konfidencial, ZRRE-ja dhe SKE duhet t'i mbrojnë këto informata konfidenciale dhe duhet të sigurohen që këto dokumente nuk do të shpalosen në mënyrë publike.

Neni 24 Gjuha zyrtare

1. Kjo rregull nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhët serbe dhe angleze. Në rast të dallimeve, duhet të mbizotërojë versioni shqip.



Neni 25 Interpretimi

1. Në rast të paqartësisë rreth cilësdo dispozite të kësaj rregulle, Bordi do të ofrojë qartësime.

Neni 26 Plotësim-ndryshimet e rregullës

1. Kjo rregull i nënshtrohet shqyrtimit dhe plotësim-ndryshimit nga ana e bordit.
2. Procedurat për plotësim-ndryshimin ose modifikimin e kësaj rregulle janë të njëjta me ato të aplikueshme për miratimin e saj.

Neni 27 Hyrja në fuqi

1. Kjo rregull do të hyjë në fuqi në datën në të cilën miratohet nga Bordi. Ajo do të duhet të publikohet në webfaqen zyrtare të ZRRE-së.

(Fundi i dokumentit)